

Luljeta BOZO

Datëlindja: 02.10.1942

Vendlindja: Tiranë

Email: Luljeta.Bozo@parlament.al



Jetshkrimi

Luljeta Bozo ka lindur më 2 tetor 1942 në Tiranë. Ajo është një profesore në fushën e inxhinierisë, dhe një nga emrat më të vlerësuar akademike në Shqipëri. Ka botuar 33 libra profesionale, në fushën e inxhinierisë, shkencës dhe gjeoteknikës dhe është kryetare e Shoqatës së Gjeoteknikëve të Shqipërisë. Ka përfunduar studimet në degën Inxhinieri Ndërtimi pranë Universitetit të Tiranës në vitin 1965 ku ka përfunduar edhe Doktoraturën në vitin 1989. Përgjatë gjithë karrierës së saj ka qenë e angazhuar në sferën akademike, duke numëruar shumë vite në pedagogji ku prej vitit 1994 mban titullin profesor. Që prej vitit 2011 ajo është anëtare e Shoqatës Amerikane për Përparimin e Shkencës(AAAS) si dhe e Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave. Në vitin 2002, u përfshi nga International Biographical Centre në Cambridgeshire, në botimin e 3-te (The International Who's Who of Women 2002), si një nga gratë shkencëtare më të mira të vitit.

Ndër kualifikimet më të rëndësishme janë ato në Paris dhe Itali. Ajo ka 52 vjet aktivitet pedagogjik në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politenik të Tiranës, Universitetin Epoka dhe Universitetin POLIS. Vazhdon të jetë kryetare e Shoqatës së Gjeoteknikëve të Shqipërisë si dhe anëtare e Shoqatës Botërore të Mekanikës së Dherave dhe Gjeoteknikës Inxhinierike.

Është autore e 33 librave të botuar, 4 dispencave për nivelin master dhe bachelor, 3 monografive, 63 punime në simpoziume, konferenca ndërkombëtare në gjithë botën, bashkë autore në tema shkencore me rëndësi kombëtare, me dhjetëra studime e projekte në fushën e gjeoteknikës, udhëheqëse e dhjetëra diplomave e mikrotezave për Master Shkencor, doktoraturave të mbrojtura , anëtare e shumë forumeve dhe komiteteve shkencore në konferenca ndërkombëtare gjatë gjithë aktivitetit të saj si anëtare e Senatit, zv.dekan, përgjegjëse departamenti etj.

Luljeta Bozo u zgjodh Deputete e Kuvendit të Shqipërisë në Zgjedhjet Parlamentare të 25 prillit 2021, duke kryesuar listën e PS për Tiranën.

